

KOSOVARIA

Ballina: Drisilda Bare
Foto: Mariglen Ballhysa



**GJEST I RRALLË
NË KOSOVËN
E PASLUFTËS**

**BJERI PRISHTINËS
FUND E KRYE,
NJERI ME LIBËR N'DORË
NUK SHEH!**



**MOS PI KAFE ME ATË
QË TA PRISHË DITËN**

**KUSH ËSHTË SPONSORI I
DISA KËNGËTAREVE TONA**

**DASHNORET MË LANË
PA U MARTUAR**

BUILDING BY DRISILDA

**TË JESH GRUA DHE DREJTORESHË
E NJË KOMPANIE TË MADHE SI
"BUILDING" SH.P.K. NË TIRANË**





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend

ANTALYA | TURKIYE



SHERWOOD
gölköyü Lara



SHERWOOD
gölköyü Kemer



SHERWOOD
Dünya Beach



3UE
Tuzla
Bata



SHERWOOD
Pamuk Beach



GREENWOOD
Sarıyer Beach



GREENWOOD
Kemer Beach

www.sherwoodhotels.com.tr | www.greenwoodhotels.com.tr

+90 444 88 07



Opinionistët i japin kosës haptë!

Derisa i shikoj në mbrëmje debatet televizive mbi tema të ndryshme, shoh se shumë nga opinionistët i japin kosës haptë dhe secili flet haptazi për partinë politike që e përkrahë!

Jam kureshtar i ngjarjeve të ditës. Andaj, me kënaqësi i pres emisionet televizive në mbrëmje dhe nga kanali në kanal përcjell debatet mbi tema të ndryshme...

“OTKOSI” NUK PO U DEL KURRQYSH!

Por, disa opinionistë po i japin kosës haptë dhe “otkosi” nuk po u del kurrrqysh!

Si i ri kur isha, më thoshte im at që kosës të mos i jepja haptë, se livadhi nuk kositet mirë!

Dhe, teksa e shikoja të mërkurën një debat të tillë, gruaja më tha:

“A po i dëgjon sa mirë paska për t’u bërë?!”

“Po, grua, mirë ka me u bërë po të veten këta që po flasin, po debatojnë?! Por, këta askush si pyet!”, i them unë.

“E, kur si pyet kush, pse dalin në televizor? Pse shesin mend para nesh se janë të dijshtëm?!”, më thotë gruaja me zë të lart.

“Dalini se paguhen, grua! Paraja, thoshin, e çon edhe ujin përpjetë!”, i

them, më shumë për ta përmbyllur këtë muhabet.

KOSOVA DO TË BËHET LIVADH ME LULE!

Dhe, teksa dua ta ndërroj kanalin, gruaja më thotë:

“Mos e ndërro kanalin! A po i dëgjon sa mirë po flasin?! Opinionisti që po anon kah “Vetëvendosja” po thotë se “Vetëvendosje” në mandatin tjetër ka me e bërë Kosovën livadh me lule!”

“Po, grua, me gojë po flasin mirë, a me vepra krejt ndryshe!”, i them.

Dhe, pas këtij muhabeti, shyqyr Zotit, gruaja nuk e zgjati muhabetin dhe e ndërrova kanalin televiziv. Për fat të mirë, në “RTSH 3”, hasa në një reportazh ku flitej për bukuritë e Luginës së Valbonës dhe u rehatova edhe unë e edhe gruaja ime...

Burim Bajrami



Bjeri Prishtinës fund e krye, njeri me libër n'dorë nuk sheh!

Në ditët e sotme, sipas të anketuarve tanë, por edhe buri-meve të tjera, del se kosovarët lexojnë fare pak, për të mos thënë fare! E, kjo merret si një ndër dukuritë më negative në shoqërinë tonë dhe paraqet rënie të arsimimit dhe edukimit të popullsisë sonë.

Një gjë e tillë shihet edhe në panairët e librit që organizohen në Prishtinë, Tiranë, Ulqin e Diasporë. Sidoqoftë, sa në të vërtetë lexohet te ne, flasin të anketuarit tanë...

PORTALET

JANË BËRË "BOZË"!

Diamant Curri thotë se në Kosovë paslufte kishte një trend leximi.

Por, me avancimin e teknologjisë, gjërat filluan të ndryshojnë. Në vend të gazetave e revistave të ndryshme u avancuan portalet. E, në portale s'ke çka lexon veç lajmeve, herë-herë të përsëritshme prej një portali në tjetrin!
"Unë, personalisht ende lexoj, edhe pse ka katër vjet që i kam kryer studimet në letërsi. Më ka mbetur në shpirt të lexoj romane,

kryesisht të shkrimtarëve nga Shqipëria, meqë jam i mendimit se ata më rrjedhshëm e paraqesin gjuhën e shkruar", thotë ai.

LEKTURËN SHKOLLORE VEÇ KUR S'KE QARE!

Erëblinë Tafa është nxënese në njërin nga gjimnazet e Prishtinës. Është nxënese e mirë, por, siç

Bukur të rrinin kulet e reja!

E kam marrë letrën tënde mbrëmë dhe jam mërzitur shumë që po të lypin Bajraktarët.

Por, unë nuk heq dorë prej teje. Dje, në ara, bukur të rrinin kulet. Ishe e mahnitshme...

Nuk më hiqet merakun për ty nëse të japin. Por, do gjejmë një dalje dhe do i flakim lotët. Do të të grabis, tek e fundit... Shkojmë te daja në Shkup nëse vjen puna deri aty...

Kam fol me dajën. Më ka thënë se mundemi me shkua te ai naj ditë në banesën e tij se e ka një dhomë që nuk e shfrytëzon, derisa të merren vesh burrat.

Nuk mendoj se zgjat shumë pajtimi, sepse baba yt nuk është njeri i keq.

Kur të pash dje në arë, m'u duk se ia more rrezet diellit!

Më shumë më ngrohje ti sesa dielli!

E kam frikën e Bajraktarëve se janë të fortë ata...

Mbështjelle letrën me mindil, që t'ia marrë erën tënde!"

Musa

thotë ajo, më me ëndje dëshiron të lexojë ndonjë lajm shou-bizi në portale sesa të lexojë ndonjë roman. Romanet a përmbledhjet e poezive për lekturë shkollore, thotë ajo, i lexoj se jam e detyruar. Përndryshe, sipas saj, ka kaluar koha e leximit...

"E, koha e cilit lexim është?", ishte pyetja që ia bëra Erëblinës. "Është koha e leximit të lajmeve të shkurta, sa për të qenë në dijeni se çka po ndodhë. Dhe, çka po ndodhë jo në politikë, se na ka ardhur në maje të hundës politika, por të jemi në rrjedha të ngjarjeve të ndryshme argëtuese, kryesisht nga shou-bizi vendor dhe ndërkombëtar".

ATA QË NUK LEXOJNË NUK DINË TË SHPREHEN!

Dituri Gashi, motër medicinale, nga Prizreni, është e mendimit se, meqë jemi në shekullin XXI, teknologjia ka përparuar shumë, andaj ka edhe zgjidhje të tjera se si të mësojmë veç librave. Interneti, bie fjala, është një burim i mirë i njohurive. Sepse, po dite ta shfrytëzosh mirë internetin, di të gjesh gjëra të mira nga jeta, veçmas nga historia kombëtare, shprehje të bukura letrare etj.

"Po qe se je i interesuar të mësosh edhe për gjëra të ndryshme shkencore, qofshin ato edhe nga shkenca mjekësore që e kam profesion, në internet gjen me bollëk dhe mund të mësosh njëjtë sikur të lexosh një libër shkencor, bie fjala, nga mjekësia", thotë Dituria.

Por, sidoqoftë, thotë ajo, duhet të lexojmë sa më shumë romane, sepse secili roman paraqet një ngjarje. E, në anën tjetër, mësojmë edhe të shprehemi mirë, drejt, rrjedhshëm.

"Ata që në jetën e tyre nuk kanë lexuar kurrë asnjë libër jashtëskollor, nuk kanë njohuri të përgjithshme dhe s'dinë të shprehin. Këtë më së miri e vërejmë në televizionet tona, kur gazetarët disa këngëtarëve, modelëve, sportistëve e të tjerëve ua nxjerrin fjalët, siç thuhet, me "darë", sepse goja dhe mendja e tyre nuk di të shprehet rrjedhshëm", thotë Dituria.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT...

Njeriu di të flasë pastër e rrjedhshëm vetëm po qe se ka lexuar literaturë të ndryshme të shkrimtarëve tanë të njohur dhe të atyre botërorë.

Andaj, nuk thonë kot: Njeriu vlen aq sa lexon!

Isa ILAZI

Kur u vra poeti edhe qielli lotonte!



Ymer Elshani

U bënë 25 vjet nga vrasja makabre e poetit nga Drenica, Ymer Elshani. Ai u vra e u masakrua më 17 prill 1999, nga forcat serbe në fshatin Poklek të Vjetër të Drenasit, bashkë me gruan, të katër djemtë, nënën, kunatën dhe me gjashtëdhjetë bashkëfshatarë të tij.

PAK BIOGRAFI...

Ymer Elshani u lind në fshatin Korroticë e Poshtme të Drenasit, më 1948. Shkollën fillore e kreu në Komoran, ndërkaq Shkollën Normale dhe Fakultetin Filozofik, Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, i kreu në Prishtinë. Pas diplomimit në fakultet punoi në Gjimnazin "Skënderbeu" të Drenasit, si profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe, e më vonë edhe drejtor i shkollës.

Në vitin 1981, në kuadër të diferencimeve politike që u bënë pas demonstratave në Kosovë, Ymer Elshanin e përjashtuan nga puna dhe ia ndaluan publikimin e shkri-

meve, me pretekst se ishte organizator i demonstratave në Drenas.

DITA E ZEZË E 17 PRILLIT 1999...

Në kohën e bombardimeve të NATO-s ndaj caqeve serbe, më 15 prill 1999 Ymeri bashkë me familjen u dëbua nga fshati dhe u vendos në Poklek të Vjetër.

Më 17 prill 1999, herët në mëngjes, ai bashkë me gruan, fëmijët, nënën, babanë e me bashkëfshatarë të tjerë tentojnë të hyjnë në Drenas, por policia serbe gjysmën e asaj turme e kthen prapa. Ymeri me të vetët, por edhe me bashkëfshatarë të tjerë strehohen në shtëpinë e Sinan Muqollit, për t'i terur rrobat e bëra qull nga shiu që binte rrëke.

Por, po atë ditë policët serbë kishin hyrë në shtëpinë e Sinan Muqollit dhe nga turma e strehuar aty, ku kishte edhe fëmijë, gra, vajza, e kishin nxjerrë Ymer Elshanin dhe Sinan Muqollin.

Sapo i kishin nxjerrë jashtë, ishin dëgjuar krismat e automatikëve, të cilat ua kishin shuar jetën mizorisht. Pas kësaj, policia

kishte hedhur bomba në dhomën ku po qëndronin të strehuarit e tjerë, pesëdhjetë e shtatë vetë.

Pastaj, policët zbrazin plumba nga automatiku, duke i lënë të vdekur pesëdhjetë e një vetë. Në mesin e tyre ishte edhe bashkëshortja e Ymer Elshanit, Nafija (45 vjeçe) me të katër bijtë Ardianin (25), Miranin (20), Kujtimin (15) dhe Nderimin (10), si dhe kunatën Shukrijen.

Të nesërmen në një shtëpi afër vritet edhe nëna e Ymer Elshanit, Nailja (75), motër e poetit dhe veprimtarit të shquar, Fazli Greiçevic, i cili, po ashtu, qe vrarë nga UDB-a derisa po qëndronte në burg për shkak të veprimtarisë së tij patriotike.

TRUPI I POETIT ME NËNË U GJETËN NË BUNAR!

Trupi i Ymer Elshanit dhe i nënës së tij u gjetën pas lufte në bunar.

Nga masakra që iu bë familjes së poetit Ymer Elshani, për fat, shpëtoi vajza e poetit, Teuta Ymer Elshani, që ndodhej në atë kohë në studime në Universitetin e Prishtinës, tash e vetmja në familjen Elshani.



MOS PI KAFE ME ATË QË TA PRISHË DITËN!



Një djalë e pyeti plakun: Ç'është dashuria? Plaku iu përgjigj: Shko në kopsht dhe ma sill lulen më të bukur.

Djali shkoi në kopsht dhe pas pak u kthye duarthatë.

- E gjete? - e pyeti plakun.

- E gjeta një lule të bukur, por vazhdova ta kërkoi një tjetër, duke shpresuar se do ta gjej edhe më të bukur. Më vonë kuptova se ajo ishte më e bukura dhe u ktheva ta merrja, por nuk e gjeta më! - i tha djali.

E po, kjo është dashuria, dashuria e vërtetë. Nuk e vlerëson, nuk e kupton, nuk ia di rëndësinë derisa ajo qëndron përballë teje, është me ty, në krahët tu, por e kupton pasi ta kesh humbur... Dhe, në botën me 7 miliardë njerëz mund të të duket krejt bosh kur të mungon personi që e do, e dashuron...

*

Gjërat më të lumtura në jetë janë falas: familja, përqaftimet, buzëqeshjet, puthjet, dashuria, shoqëria...

Nuk thonë kot se gjithçka që ka nevojë një njeri është një dorë për ta shtrënguar dhe një zemër

për ta kuptuar.

E, nuk ka gjë më të shtrenjtë, më të bukur në jetë se të gresh një njeri që të lexon, të kupton, ta ndjen shpirtin, zemrën...

E pyesin një trëndafil:

"Nuk të dhembë kur të këpusin?"

"Jo", përgjigjet ai dhe shtoi: "E harroj dhembjen time kur mendoj se do të jem arsyeja e buzëqeshjes së dikujt tjetër!"

Dhe, sot, bëhuni arsyeja e buzëqeshjes së dikujt!

Por, jo edhe e gjithkujt...

*

Thonë: jeta është një filxhan kafe, me shije herë të ëmbël e herë të hidhur. Nuk është me rëndësi shija e kafes, rëndësi ka me kë e pi kafen, sidomos të mëngjesit.

E, po qëllon personi që të përshtatet me muhabet, edhe shijen e kafes së hidhur nuk e heton.

Por, po që se personi nuk të përshtatet, ta prishë shijen e kafes, e edhe ditën!

Andaj, kafen e mëngjesit pije me atë që ta ndreqë ditën, të jep sevda në shpirt, në zemër...

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Nëballinë

Drisilda Bare, e lindur në qytetin e Fierit, pasi mbaroi studimet e ciklit të ulët dhe gjimnazin në qytetin e saj të lindjes, u transferua në Tiranë si studente, ku do të niste studimet e ciklit Bachelor në Universitetin Europian të Tiranës, në Degën Informatikë Ekonomike (Administrim Biznesi). Pas përfundimit të shkollës trevjeçare, zgjodhi të ndiqte Masterin Shkencor në fushën e IT-së, ku edhe u diplomua në të dyja ciklet.



BUILDING by Drisilda të jesh grua dhe drejtoreshë e një kompanie të madhe si "Building" SH.P.K. në Tiranë

Pas disa eksperiencave të vyera profesionale, Drisilda Bare mban pozicionin e drejtoreshës së shitjeve dhe marketingut në kompaninë e ndërtimit "Building" SH.P.K në Tiranë.

Kjo femër e zonja e profesioniste e dëshmuar, e bënë punën e saj me shumë dashuri e korrektësi. Drisilda Baren, nga "Building" SH.P.K. në Tiranë e karakterizon energjia pozitive, është dinamike, diplomate, shumë korrekte dhe ndonjëherë e sertë për hir të pozicionit të pozitës që mban.

Formulë suksesi në jetë e punë e konsideron frymën e bashkëpunimit të gjithë njerëzit me të cilët punon dhe që ka një marrëdhënie pune.

Të jesh korrekte, të kesh një komunikim po aq sa serioz në aspektin e punës, por edhe shoqëror, është një lloj formule për të hapëruar përpara me sukses. "Ç'do kush nga ne duhet në jetë t'i vendosë një qëllim të caktuar vetes dhe me përpjekje e korrektësi ta arrijë atë. Përpjekje plus aftësi



është çelësi i një biznesi të suksesshëm. E, duke punuar në drejtim të aftësive dhe në drejtim të përpjekjeve, do të arrijmë ç'do gjë.

Përmirësimi i aftësive është rezultat i përpjekjeve dhe kohës sonë. Përpjekje + Kohë = Motivim.

Dhe, gjërat përmirësohen dite pas dite: motivimi është rezultati i natyrshëm i ciklit virtuoz që nisë me përpjekjen.

Të ndihemi mirë me veten na jep doza të vogla motivimi, gjë që krijon një cikël virtuoz që përkthehet në një burim të përshtatshëm motivimi. Ne kemi nevojë t'i bëjmë vetë gjërat e duhura, sepse kur bëjmë gjërat e duhura, na jepet mundësia të përmirësohemi", thotë Drisilda Bare, me të cilën flasim edhe për CV-në e saj profesionale.

Tutje tregon se ka punuar në sistemet bankare në Tiranë, ku ka fituar eksperiencë të gjatë në etikën e punës, bashkëpunimit, komunikimit, marrëdhënien me eprorët etj.

"Tashmë eksperiencia më e mirë dhe më e bukur imja është në "Building" SH.P.K., pasi këtu kam gjetur vetveten, jam plot energji në një ambient pune jashtë mase familjar, korrekt, ku, mbi të gjitha, më nxitë ambicien time për t'u rritur akoma më shumë profesionalisht, duke pasur një synim dhe një motivim kryesor që të rritem së bashku me "Building"-un, ashtu duke lënë gjurmë".

SI ERDHI DRISILDA BARE NË "BUILDING" SH.P.K.?

"Meqë po kërkoja më shumë nga vetja për rritjen time profesionale, hasa papritur në një nga faqet e marketingut të Kompanisë "Building" SH.P.K. dhe aplikova.

Jo më shumë se dy ditë më vonë mora një telefonatë nga zyra e Kompanisë për të dhënë intervistë.

Nuk di t'i përshkruaj emocionet e asaj dite, e, mbi të gjitha, emocionet kur po shkoja në intervistë.

Kisha 100 pyetje në kokën time dhe ishte një punë që hynte në pasionet e mia.

Dhe, falë mirësisë së eprorëve të Kompanisë "Building" SH.P.K., ngrohtësisë së dhënë nga një ambient pune familjar dhe aftësive të mia të dhëna në intervistë, m'u besua zyra dhe departamenti i shitjeve dhe marketingut të kompanisë. Nuk arrija dot ta besoja, ishte përgjegjësi, sepse duhet të tregoj veten time. E, mbi të gjitha, të nderoja eprorët e mi që më besuan".

Andaj, Kompaninë "Building" SH.P.K. ajo e konsideron familjen e saj dhe shton:

"Është një kompani e cila ka nisur eksperiencën në fillimet e saj me rikonstruksionet e objekteve dhe ambienteve.

Më pas, duke parë nevojën e tregut, vendosi të zmadhohej dhe të kalonte 100% në fushën e ndërtimit, tashmë



edhe me objektet e saj, duke marrë përsipër që klientëve apartamentet e tyre të ëndrrave t'i bënte realitet, me punime shumë cilësore, të sigurt, të projektuara në mënyrë moderne, korrekte në ndërtim dhe, mbi të gjitha, me çmime super okazione për tregun e Shqipërisë, e veçmas të Tiranës.

Të gjithë klientët tanë janë partnerë tanë më të besuar, që investojnë pothuajse në të gjithë objektet që "Building" SH.P.K. i realizon.

MË SHUMË PËR "BUILDING" SH.P.K. NË TIRANË?

"Building" SH.P.K është një firmë lider ndërtimi me bazë në Shqipëri, e spe-



cializuar në ndërtimin e ndërtesave komerciale dhe projekteve në zhvillim. Në "Building" SH.P.K zotërojnë një pasuri të ekspertizës në ndërtimin e ndërtesave komerciale, duke përfshirë një gamë të larmishme projektesh, komplekset e zyrave, qendrat e shitjes me pakicë, objektet e mikpritjes etj. Ekipi i përkushtuar i profesionistëve kombinon njohuritë e industrisë, aftësitë teknike dhe zgjidhjet inovative për të ofruar rezultate të jashtëzakonshme në çdo projekt. Ajo që vlen veçmas të theksohet është se kjo kompani zhvillon biznes me ndershmëri, transparencë dhe integritet, duke iu përmbytur standardeve më të larta etike në të gjitha ndërveprimet.

"BUILDING" SH.P.K NË TIRANË - TË PËRKUSHTUAR PËR TË OFRUAR PROJEKTE ME CILËSI

Të pa kompromis në cilësi, duke tejkaluar standardet e industrisë dhe pritjet e klientëve. Siguria dhe mirëqenia e punonjësve, nënkontraktorëve dhe vizitorëve të vendit, janë parësore.

"Në "Building" SH.P.K. mbajmë protokolle rigorozë të sigurisë për të siguruar një mjedis të sigurt pune. Gjithashtu, i japim përparësi kënaqësisë së klientit, duke u përpjekur të kuptojmë dhe plotësojmë nevojat e klientëve, si dhe duke nxitur partneritete afatgjata të ndërtuara mbi mirëbesim dhe besueshmëri.

SHËRBIMET E OFRUARA:

Ndërtimi i ndërtesave komerciale:
Nga koncepti deri në përfundim ofrojnë shërbime ndërtimi gjithëpërfshirëse, të përshtatura për kërkesat unike të projekteve komerciale.
Menaxhimi i projektit: Menaxherët me përvojë të projektit mbikëqyrin të gjitha aspektet e ndërtimit, nga planifikimi e deri te menaxhimi i buxhetit dhe kontrolli i cilësisë, duke siguruar ekzekutim të pandërprerë të projektit.
Dizajn-ndërtim: Si firmë ndërtimi me shërbime të plota, ofrojnë zgjidhje të integruara të projektimit, duke thjeshtuar procesin e ndërtimit dhe duke ofruar zgjidhje me kosto efektive dhe çelësi në dorë. Rinovimi dhe rimodelimi: Në "Building" SH.P.K. u japin jetë të re strukturave ekzistuese përmes shërbimeve të ekspertëve të rinovimit dhe rimodelimit, duke rigjallëruar hapësirat e duke ruajtur integritetin tyre arkitekturor.



EKSPERIENCA PUNE:

- "Gardenian", Rruga "Besim Imami, kisha Ortodokse në rrugë të Kavajës;
- "Aura" në Laprakë;
- "Luxor 3" në rrugën "Tefta Tashko Koço";
- "New Bulevard", në Bulevardin e Ri;
- Pazarin e Ri;
- "Platinum I", në Paskuqan;
- "Platinum II", në Paskuqan.

PSE TA ZGJIDHNI "BUILDING" SH.P.K.?

Me shumë vite përvojë në industri, sjellin një thellësi njohurish dhe ekspertizë për çdo projekt që bëjnë.

Ekipi i profesionistëve përbëhet nga arkitektë, inxhinierë, menaxherë projektsh dhe zejtarë të aftë, të cilët janë të përkushtuar ndaj përsosmërisë në fushat e tyre përkatëse.

Përqafojnë inovacionin dhe shfrytëzojnë teknologjitë më të fundit, si dhe

metodologjitë e ndërtimit për të optimizuar efikasitetin, për të minimizuar mbeturinat dhe për të dhënë rezultate superiore.

Të përkushtuar ndaj praktikave të qëndrueshme të ndërtimit, duke përfshirë zgjidhje me efikasitet energjetik dhe materiale miqësore me mjedisin në projekte. "Building" SH.P.K. ofron korrektësi, punime moderne dhe shumë cilësore, pozicione elitare me vendndodhje në pikat kyçe të Tiranës, siç janë: Pazarin e Ri, Rruga e Barrikadave, Ish-Ekspozita, Don Bosko, Paskuqan 1

dhe Paskuqan 2 në Laprakë etj. Së shpejti kompania do të disponojë objekte të tjera në pika kyçe, që bëjnë të mundur pushtimin dhe zgjerimin e kompanisë si në Tiranë e jashtë saj. Gjithmonë me sukses!

Nderim Neziri

 /building.shpk

 /mayla_drissi

Kontakt Building: **+355 69 20 69 497**

Web Building: **www.building.al**



Masakrën e komunistëve grekë mbi kosovarët e mbajti fshehtë gjatë gjithë regjimit komunist Enver Hoxha!

Si i dogjën grekët 14 kosovarë për së gjalli?

“Në ishullin e Kretës, 300 komunistë grekë vranë dhe dogjën 14 nacionalistë kosovarë”. Masakra e panjohur e 9 majit 1947, që u mbajti e fshehtë nga Enver Hoxha!

Në mesin e shumë masakrave që kanë kryer serbët, malazezët dhe grekët, që asnjëherë nuk u ngopën me grabitjen e tokave shqiptare, hyn edhe Masakra e komunistëve grekë, më 9 maj të vitit

1947, në Kretë të Greqisë. Kjo masakër është ndër më të veçantat për llojin e krimeve e masakrave të kryera. Është e veçantë për faktin se ata

shqiptarë atdhetarë, që ishin antikomunistë të përбетuar, kishin marrë strehim politik në Greqi. Por, greku s’ka besë, e proletarët komunistë gjithherë kanë bashkëpunuar

në mes vete, siç ishte edhe ky bashkëpunim në mes komunistëve grekë, jugosllavë dhe shqiptarë, për vrasjen e nacionalistëve atdhetarë nga Kosova. Shumica nga familjarët e të vrarëve nuk e kanë ditur dhe nuk mund ta dinë edhe sot, se ku ju janë vrarë familjarët e tyre, e mos të flasim për varret e tyre dhe vendin se ku janë gjuajtur pas vrasjes së tyre, që u ka humbur çdo shenjë.

NGA RRJEDHIN TË DHËNAT?

Materiali është marrë nga Arkivi i Kapidan Ndue Gjon Markut, që është edhe arkivi i "Bllokut Kombëtar Independent".

"Më 9 maj të vitit 1947, në orën 4 pas mesnate, në qendrën e Nënprefekturës Fera Petra në Kretë, një batalion i komunistëve grekë, rrethojnë shtëpinë ku flinin 28 shqiptarë nga Kosova, emigrantë politikë. Shqiptarët ishin vendosur në këtë vend prej autoriteteve greke dhe merreshin me punë bujqësie, pranë familjeve greke të vendit.

Në këtë mënyrë, ata siguronin shpenzimet e jetesës së tyre.

Natyrisht, nuk kishin asnjë lloj arme. Nuk kishin asnjë mbrojtje të posaçme nga ana e autoriteteve vendore.

Natën e 9 majit 1947, batalioni i komunistëve grekë, i përbërë prej më shumë se 300 vetash, nisi ta rrethojë ndërtesën e nënprefekturës, kazermin e korofillakavet dhe mbasandej shtëpinë ku flinin. Mbase e plotësojnë rrethimin mirë, fillojnë sulmin. Patrullat komuniste u lëshojnë zë shqiptarëve dhe kërkojnë t'u hapin portën e shtëpisë dhe të dorëzohen të gjallë. Mirëpo, nuk shkon shumë kohë dhe patrulla komuniste greke fillon të zbrazë armët kundër shtëpisë dhe përpiqen që të thyejnë portën e të hyjnë brenda.

Shqiptarët, kur e panë se po rrezikoheshin, filluan të luftojnë kundër komunistëve grekë.

Megjithatë, ata nuk kishin armë të tjera, përveç trimërisë personale, zëmërs dhe idealit të tyre.

Sidoqoftë, i kishin veglat e punës: shatër, lopata, kazma, sëpata...

Ndërkaq, filluan të vriten prej plumbave të grekëve antikomunistët e

parë: Jonuz Emini, kryetar i grupit, Idriz Sallova, Latif Kuqi, Riza Matoshi, Zejnel Mehmeti, Qerim Hajdari e Halil Idrizi.

Por, edhe nga ana e komunistëve mbetën pesë të vrarë e disa të plagosur, që tërhiqen e largohen.

Dhe, duke parë se shqiptarët nuk dorëzoheshin, komunistët grekë i vënë zjarrin shtëpisë, duke ndezur disa fuçi me benzinë.

Ndërkohë, duke kaluar përmes zjarrit e flakëve, Osman Sinani sulmon i pari, duke dal jashtë shtëpisë. Dhe, në shpejtësi ia merr armën një komunisti grek, të cilin edhe e vret.

Por, pas pak, ai (Osman Sinani) bie mbi tokë i vrarë, duke thirr: "Rrnoftë Shqipnia, Rrnoftë Kosova!".

SI RRODHI NGJARJA TUTJE?

Pas Osmanit, sulmon vëllai i tij, Bajram Sinani. E, fill pas tij Isak Ahmeti, Haxhi Halili, Banush Berisha, Bajram Berisha, Kadri Berisha, Mustafa Bajraktari, Ahmet Uka, Fiqri Sejda dhe Hidajet Arifi. Këta, për çudi, shpëtojnë nga flakët e plumbat e komunistëve grekë...

Ndërkohë, plagosën rëndë: Qerim Ibrahim, Bajram Gorani, Hysen Rama, Nazif Vata, Nazif Varoshi, Aziz Murati dhe Istref Selmani.

Prej këtyre, të plagosurve, tre të parët, Qerim Ibrahim, Bajram Gorani dhe Hysen Rama vdiqën pak më vonë.

Mirëpo, kishin mbetur brenda në shtëpi, nën flakët e mëdha: Xhemal Matoshi, Rexhep Gashi dhe Ymer

Sakoli.

Bajram Sinani, njëri ndër ata që shpëtuan prej zjarrit, futet në shtëpinë e priftit, por për fat të keq edhe këtu e rrethojnë armiqtë.

Por, shpëton duke u hedhur prej dritares dhe fshihet në një vend të sigurt. Vlen të thuhet se asnjë shqiptar nuk u dorëzua i gjallë...

Sidoqoftë, lajmi i hidhur i vrasjes tragjike të shqiptarëve nga Kosova shkaktoi te të gjithë të mërguarit shqiptarë një dëshpërim të patregueshëm.

SI PËRFUNDIM...

Në këtë masakër, që e kryen komunistët grekë më 9 maj 1947 në Kretë, ranë heroikisht 14 atdhetarë shqiptarë: Jonuz Emini, kryetar i grupit, Idriz Sallova, Latif Kuqi, Riza Matoshi, Zejnel Mehmeti, Qerim Hajdari, Halil Idrizi, Osman Sinani, Qerim Ibrahim, Bajram Gorani, Hysen Rama, Xhemal Matoshi, Rexhep Gashi, Ymer Sakoli.

Ndërkaq, u plagosën rëndë: Nazif Vata, Nazif Varoshi, Aziz Murati dhe Istref Selmani.

Me plagë të lehta ishin: Bajram Sinani, Isak Ahmeti, Haxhi Halili, Banush Berisha, Bajram Berisha, Kadri Berisha, Mustafa Bajraktari, Ahmet Uka, Fiqri Sejda dhe Hidajet Arifi.

Sidoqoftë, kjo ishte tragjedia e 28 shqiptarëve të Kosovës, ku 14 prej tyre u vranë, u dogjën dhe u masakruan nga komunistët grekë.

Për të tjerët që shpëtuan nuk dihet për fatin e tyre të mëtutjeshëm...

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play



Xhelozia është ana e errët e dashurisë!

Nga vjen xhelozia? A është e lindur apo e fituar? Pyetje pa përgjigje deri më tani!

Edhe pse për xhelozinë në martesë është "gjetur" një tezë, është një bindje në ndërdijen tonë që kryen një rrugë e dy punë, thuhet se kush nuk xhelozon nuk dashuron.

Unë, personalisht, gati në përfundim të dekadës së tretë martesore, preferoj të parën, për të injoruar të dytën, sepse është një lloj ledhatimi me një premisë narcizmi, që na bën të ndihemi mirë qoftë edhe për një moment.

Gati harrova të cekë të dytën, se xhelozia është edhe mungesë e zgjuarsisë dhe kjo tregon shumë për ne. Është sikur ajo kur drejton gishtin tregues në drejtim të tjetrit dhe harron se tre ia ka drejtuar vetes!

Xhelozia në martesë është shenjë e mirë dhe, para së gjithash, një shenjë e dashurisë së madhe.

Së paku, unë jam edukuar kështu dhe me këtë besim gjatë kam justifikuar xhelozinë dhe kam "shijuar" dashurinë!

XHELOZIA NUK KA TË BËJË FARE ME DASHURINË!

Po sikur të mos e gënjejmë veten me përralla të bukura dhe të përballimi me të vërtetën se është pikërisht xhelozia që nuk

ka të bëjë fare me dashurinë.

Xhelozia është gjithçka përveç dashurisë. Xhelozia është një emocion i dhimbshëm, ndjenjë frike, pasigurie, shqetësim mungese, boshllëk në shpirt, virtut apo e metë ende e paqartë, por shumë e qartë se është në secilin nga ne.

Mirëpo, kur doza e xhelozisë si reagim emocional tejkalon kufijtë e arsyes së shëndoshë, atëherë kemi të bëjmë me një mungesë të vet dashurisë, mungesë vetëvlerësimi dhe edukim të çoroditur të vlerave tona dhe qenies tonë hyjnore dhe unike.

Ne, të gjithë, pa marrë parasysh gjininë, nuk i takojmë askujt. Ne, thjesht, jemi këtu për të shpalosur potencialin tonë hyjnor dhe misionin tonë shpirtëror. Ne jemi këtu për të plotësuar njëri-tjetrin, e jo për t'u bërë pronë e dikujt, sepse çdo gjë në planetin tokë është e huazuar, pos shpirtit që i takon vetëm burimit, por jo njerëzimit.

RIVALITETI DHE FRIKA E TEPRUAR!

Xhelozia si ndjenjë instinktive e lashtë vjen nga rivaliteti dhe frika e tepruar, për të ndarë dashurinë me dikë tjetër, ku zanafilla fillon qysh në fëmijërinë tonë të hershme. Harrojmë se ne nuk mund të humbim kurrë çka nuk është e jona.

Megjithatë, jo të gjithë marrim guximin të shprehim kur ndjejmë se diçka nuk po shkon mirë më ne dhe dashurinë tonë. Dhe, këtu dua të ndalem, sepse ne nuk mund t'i mendojmë ndjenjat tona, ato vetëm mund t'i ndjejmë. Kur ndjejmë shumë, ne edhe reagojmë. Por, jo gjithmonë është arsyeja që udhëzon.

Në radhë të parë, veprimet tona janë më tepër emocionet tona. Ne, kur reagojmë, japim sinjale non verbale dhe verbale, e kur këto nuk "shihen dhe dëgjohen" mund të vijë edhe deri te dhuna.

Dhe, këtu fillon sjellja pasive-agresive, siç quhet në psikologji, ku një sjellje e tillë është toksike për marrëdhëniet ndërpersonale dhe nuk mbetet kurrë pa rënë në sy. Mirëpo, ne, të humbur në përditshmëri, heshtim edhe për dhunën e cila ka ndodhur "veç një herë"!

Dhe, kur një ditë bëhet vonë, atëherë e vetmja gjë me të cilën arsyetohemi është: Pse nuk ka treguar më herët?

Fakti se i kemi dy veshë e një gojë, e ka një qëllim, të dëgjojmë më shumë, por të mos heshtim.

Janë klithmat e heshtjes së "padëgjuar", forma më e lartë e injorancës dhe për-buzjes ndaj tjetrit!

Shkëndije Pacolli



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges



Si e zbulova se kush është sponsori i disa këngëtareve tona?

Më rastisi puna në një ndejë me një biznesmen. Ajo që vlen të përmendet në atë ndejë është se atij shpeshherë i cingëronte telefoni dhe u ndërpriste biseda jonë...

Ndokujt nuk i përgjigjej në telefon, e ndokujt i shkruante sms. Ndërkohë, më thotë: "Meqë je gazetare, a do i lexosh mesazhet e VIP-ave për të cilët shkruani e i afirmoni?! Më kanë lodhur me mesazhe e kërkesa: veç para dhe gardërobë kërkojnë!". Kureshtja më shtyri t'i lexoj disa mesazhe në telefonin e tij. Çuditëm, befasohem me emrat që i lexoj... Kryesisht janë këngëtare...

* Jam te tezja momentalisht dhe nuk mund të takohemi. Lërmi paret në restorantin ku ishim dje, llokumi jem, se nesër shkoj në Shkup për klip.

* Pasha nanën, si t'kthem nga Austria kam me t'i kthy.

* A m'ke shpirt a jo. Si nuk t'vjen inati të shkoj me gardërobë të njejt në xhirim... Mos më detyro të shkoj te tjetri.

* Boll e ke kryt e fort por po më intereson pse po do me ma prish punën për klip. Hajt e zbutë atë krye e shko bane pagesën në bankë se nuk me pranojnë pa u ba pagesa.

* Jam ne hall. Klipi po kushton shtrejt e pare s'kam.

* A do me ardh me mu ne Tiranë se kam takim me një grup kangtare nga Shqipëria. Le ta shohin ato se ka e kam sponsor.

Në vend të përfundimit Pasi i shënova në notesin tim këto mesazhe, u ndala dhe mendova: Në ç'nivel bien disa nga këngëtaret tona?!

Diturie Haxhaj



Gjest i rrallë në Kosovën e pasluftës...

Çifti nga Gjilani bën gjestin e rrallë, hapin dyert e dyqanit të tyre dhe ofrojnë roba falas për njerëzit në nevojë...

ENDE KA NJERËZ TË MIRË...

Çifti nga Gjilani, Gëzim e Xhani Mehmeti, pronarë të butikut "Atalanta", me rastin e Bajramit të Madh, bën një gjest shumë humanitar për njerëzit skamnorë, gjest shumë i rrallë në

Kosovën e pasluftës.

Me rastin e Ditës së Bajramit, në butikun e tyre, u veshën me roba shumë nevojtarë-skamnorë nga Kosova, por edhe Shqipëria.

Ata tregojnë se kanë dhuruar 400 pako me veshje.

"Nuk është hera e parë. Ka 6 vjet që dhurojmë, por këtë herë e kemi bërë lajmërimin më herët. Zakonisht, lajmin e japim një ditë para festës.

Por, këtë herë lajmërimin e dhamë dytri ditë përpara Bajramit dhe ka pasur kërkesa prej tërë Kosovës, e edhe prej Shqipërisë për roba për ata njerëz që kanë vërtet nevojë.

E kemi bërë për Zot dhe njerëzit në nevojë", shprehet Gëzimi, për një medium televiziv.

Ç'THOTË PRONARJA E BUTIKUT?

Gruaja e tij, Xhani, thotë se më shumë janë të fokusuar te fëmijët në nevojë. "Kur pamë që kanë nevojë familje të tjera, kemi vazhduar me pako të tjera. Nuk kemi pasur qejf që asnjë familjeje me u thënë që na vjen keq por nuk ka më. Më shumë u kemi kushtuar rëndësi fëmijëve", shprehet ajo. Shkurt e shqip: Gjest i rrallë në Kosovën e pasluftës...

BOOM



Këngëtarët tanë
që hoqën dorë
nga muzika e iu
përkushtuan fesë

Këngët
e famshme që
i adhuron bota,
e këngëtarët
dhe autorët
e tyre i urrejnë!

VIP-at shqiptarë
që humbën peshë
në mënyrë
drastike

Gjon Karrica
vë në skenë "Spotlight"
shou i parë shqiptar
me performancë elektrizuese



Gjon Karrica vë në skenë "Spotlight" shou i parë shqiptar me performancë elektrizuese

Me vite emri i Gjon Karricës është lakuar pafund në mediet rozë. Gjon Karrica është ndryshe, një ardhje tjetër në botën e muzikës shqiptare. Për publikun i njohur si Lugati, me apo pa dashje ka ngritur shpesh pluhur dhe e ka tronditur botën e shou-bizit.

U bë pjesë e “Big Brother VIP Kosova” dhe e jetoi me “100 km në orë” këtë eksperiencë televizive, duke prodhuar situata të ndryshme, nga ato më të bukurat e qesharaket, deri te situatat më emocionuese e dramatike. Por, në kohën kur ai konsiderohej personazhi më i preferuar i edicionit të parë “Big Brother VIP Kosova”, kur videot e tij kapnin miliona klikime në rrjete sociale dhe ishte shndërruar në banorin më viral, një komplikim shëndetësor e nxori nga loja dhe shou.

E, ajo i tronditi banorët dhe fansat, të cilët e deshën shumë praninë e Gjonit në atë format televiziv.

...KARRICA NUK U DORËZUA

Gjon Karrica shpejt e mori vetën për t'u kthyer në “prime” dhe për të goditur me një performancë që ndezi një valë tjetër diskutimesh. Tutje, erdhën projekte të reja, por edhe lajme për avaritë e kohëpaskohshme shëndetësore, bashkë me lajmin e mirë se ai u bë baba i një vajze me emrin Dita.

Së fundi, artisti kontrovers, ka vënë në skenë shoun e tij “Spotlight”, me performanca ngacmuese dhe me defilimin e një mori artistësh mjaft pikantë në skenë, përfshirë edhe yllin e muzikës moderne shqiptare, Altuna Sejdiun-Tunën.

Shou është mbajtur në Cyrih të Zvicrës, në “Plaza” dhe ka tubuar bashkë në një vend dashamirë të artit të Gjon Karrisës.

40 PËR QIND E PARAVE TË BILETAVE U DHANË PËR HUMANITET

Ndërkohë, pos performancave ekzaltuese, një pikë e fortë ishte edhe iniciativa humanitare për të ndihmuar fëmijët e SOS fshatit në Kosovë, për të cilët u dedikuan 40 për qind e të hyrave nga shitja e biletave.

“Spotlight” nga Lugati është mbështetur nga Spitex Melina’s medical care, Spitex am Bodensee, Plaza Zug, Il postino dhe Hair by Violeta.

N. Neziri



Këngëtarët tanë që hoqën dorë nga muzika e u përkushtuan fesë

Me gjithë talentin dhe prirjen që mund të kenë për art, jo të gjithë këngëtarët kanë fatin që ta nisin dhe ta përfundojnë karrierën e tyre me muzikë.

Për shkaqe të ndryshme, shumë prej tyre mund të ndërrojnë profesion, të ndërprejnë karrierën për një kohë të shkurtër apo edhe t'i përkushtohen fesë.

E, nuk janë të pakta rastet kur kjo e fundit ka ndodhur me një mori emrash nga estrada, që hoqën dorë nga muzika, për t'iu përkushtuar islamit.

Lista e disa personazheve të famshëm që kanë marrë një vendim të ngjashëm:



FERKI SHALA - TNT

TNT dikur ishte një nga rock-grupet më të pëlqyera në Kosovë, me hite që i rezistuan kohës e këndohen dhe ripërpunohen nga artistë të rinj edhe sot e kësaj dite.

Siç ndodhi rëndom me shumë grupe të tjera të muzikës rock, edhe TNT me kohë u tërhoqën nga muzika.

Vokalisti i këtij grupi, Ferki Shala, u përkushtua fesë islame, duke e lënë muzikën rock vetëm në arkivat e jetës së tij profesionale.

Po të shohësh me vëmendje në rrjetet sociale të muzikantit mitrovicas, sheh vetëm postime që lidhen me ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin për rëndësinë e fesë islame.

NAZMI SFISHTA – “AURORA”

I njohur me emrin artistik Nazi, ish-muzikanti Nazmi Sfishta i grupit “Aurora”, është një prej artistëve që iu dedikua fesë pasi që grupi nuk vazhduan të bëjnë muzikë konstante.

Ai ishte bërë shumë i përfolur në rrjetet sociale vite më parë, kur kishte dhënë disa intervista kontraverse, duke u shprehur se “është i dërguar i Allahut”!

Madje, në një prononcim për emisionin “Prive”, kishte thënë se pas shumë kohe “është çliruar nga djajtë”.





ENIS PRESHEVA

Kompozitori Enis Presheva dikur ishte një nga doajenët e muzikës moderne në estradën shqiptare. Madje, ai ishte ndër të vetmit që në vitet 90 ishte i njohur me zhanrin R&B, i cili para luftime ishte pak i njohur e i eksploruar në Kosovë.

Megjithatë, edhe Enisi e gjeti veten më shumë në rrugën e religjionit, duke gjetur paqen në përkushtimin ndaj fesë së cilës i takon.


Por, pavarësisht përkushtimit në fe, Enis Presheva ka qenë deri vonë i angazhuar në krijimin e projekteve muzikore për artistë të tjerë.

SHKËNDIJE MUJAJ

Ndonëse nuk ka pasur ndonjë karriërë të lulëzuar në muzikë dhe nuk ka qenë shumë e njohur për këngë, aq sa për paraqitjet e saj të ekzagjeruara në publik, këngëtarja Shkëndije Mujaj i bashkohet listës së personazheve publike që iu përkushtua fesë.

Sipas bukuroshes, me origjinë nga Peja, gjithçka nisi nga një ëndërr që ajo pa, e cila e shtyu drejt përkushtimit në islam dhe dedikimit ndaj fesë.

Mujaj, madje, ka dhënë disa intervista në televizione, ku ka folur mbi mënyrën se si e predikon fenë dhe si ka gjetur qetësinë me jetën e saj të re në Zvicër, dedikuar si një myslimane e devotshme.



FERONIT SHABANI - FERO

I fundit që përmbyllë ciklin e disa të famshmëve të estradës që iu bashkua fesë, është reperi i njohur nga Gjilani, Fero.

Shumë vite më parë ai pat një debutim mjaft të përfolur në muzikë, por me largimin e tij nga shtëpia diskografike "ON Records", karriera e tij duket sikur shkoi vetëm në rënie.

Në gushtin e këtij viti, reperi përmes një shkrimi në rrjetet sociale njoftoi se po hiqte dorë nga muzika dhe se u bënte thirrje fansave që të mos e dëgjonin muzikën e dikurshme që tani e cilëson si degraduese dhe është në kundërshtim me rregullat e fesë.

Thuajse të gjitha këto kthime në përkushtimin ndaj fesë, janë mirëpritur dhe duartrokitur nga komuniteti i myslimanëve të dedikuar ndaj fesë islame.

VIP-at shqiptarë

që humbën peshë në mënyrë drastike

Transformimet e personazheve VIP janë një nga temat më të komentuara në media...

Të shumtë kanë qenë këngëtarët, moderatorët dhe politikanët, të cilët dikur kanë qenë mbipeshë, mirëpo me punë dhe vullnet dhe duke ndjekur dietat të ndryshme kanë arritur që të perfeksionojnë linjat e tyre trupore.



SARA HOXHA

Sara Hoxha pësoi ndryshim të jashtëzakonshëm në trup brenda një viti. Ajo arriti të humbiste një numër të madh kilogramësh, pas një ndërhyrjeje nëpërmjet së cilës zvogëloi stomakun. Sara është pyetur pak kohë më parë për këtë fakt dhe është shprehur se, pavarësisht se ajo duket shumë më mirë pas kësaj, nuk do t'ia rekomandonte askujt këtë gjë.

ANXHELA PERISTERI

Prej muajsh këngëtarja Anxhela Peristeri ka vendosur që të bie në peshë. Ajo nëpërmjet postimeve të ndryshme në "Instagram", por edhe në dalje të ndryshme ka treguar se ka filluar të frekuentojë palestrën rregullisht dhe ka humbur më shumë se 12 kilogramë.



GILI

Këngëtarja Gili zbuloi për publikun se kishte humbur 27 kilogramë në 4 muaj, duke rikthyer linjat perfekte trupore. Një ndryshim shumë drastik ky që e ka arritur nëpërmjet një diete të quajtur "Paleo Diet", e që e ka marrë emrin kështu shkak të ndryshimit të ngjashme me ato të kohës së paleolitit, ku përfshihet peshku, mishi, perimet, arrat dhe farat.



LINDA HALIMI

Edhe transformimi i këngëtares Linda Halimi ka qenë një ndër më të komentuarit në medie vite më parë. Këngëtarja e njohur arriti që të humbiste 50 kilogramë dhe nga 95 kile që peshonte bie në 44 kg. Peshën ideale Linda ka treguar se e ka arritur nëpërmjet palestrës dhe një diete strikte. Ndërkohë, rikujtojmë se Linda pak muaj më parë u bë nënë për herë të parë, mirëpo nëpërmjet videove dhe fotove tregoi se i ishte rikthyer formave të mëparshme.

CAPITAL T

E mbani mend reperin Capital T në fillim të karrierës së tij?

Ai ka qenë mjaft i mbushur në trup, mirëpo viteve të fundit është kthyer në një ndër meshkujt me trupin më të mirë.

Në foto të ndryshme reperi ka treguar rezultatet e palestrës.

Ai ka treguar shpesh në postimet e tij se kujdeset shumë dhe për ushqimin që ha.



BIG MAMA

Këngëtarja Big Mama vite më parë i habitit të gjithë me transformimin në trup.

Në fillimet e saj Bigu ka treguar se mbante dieta, mirëpo ato nuk rezultuan të suksesshme dhe për këtë arsye kreu një ndërhyrje gastrike, e që i riktheu format perfekte trupore.

D. H.

Këngët e famshme që i adhuron bota, këngëtarët dhe autorët e tyre i urrejnë!

Është vështirë të gjesh dikë që nuk e pëlqen këngën legjendare "Le It Be", nga The Beatles. Ka shumë pak femra që nuk e gjejnë veten në këngën "My heart will go on" të Celine Dion.

Por, fakti se audiencia me të vërtetë i donte këto këngë, nuk do të thotë që autorët e këngëve, gjithashtu, i pëlqyen.

Bright Side solli një listë me këngëtarë që, në të vërtetë, i urrenin këngët që publiku i donte.



FRENK SINATRA "STRANGERS IN THE NIGHT"

Frenk Sinatra nuk ishte kompozitori original i këngës, por ishte ai që e bëri të famshme këtë këngë. Por, kur kompozitori u pyet se çfarë mendonte për këngën "Strangers in the Night", ai tha: "Është kënga më e keqe që kam dëgjuar ndonjëherë! Dhe, çuditërisht, vazhdoj të them me vete: Pse po e këndon akoma këtë këngë?!"

JAMES BLUNT "YOU'RE BEAUTIFUL"

James Blunt, autori i një prej këngëve më të njohura të shekullit XX, "You're Beautiful", thotë se kjo këngë ishte në radio aq shpesh sa filloi të më bezdiste. Përveç kësaj, ai thotë se kënga e tij nuk është romantike dhe ai nuk mendon se duhet të këndohet në dasma.



KATY PERRY "I KISSED A GIRL"

Katy Perry thotë se nuk i pëlqen kënga "I kissed a girl", që e bëri atë yll në gjithë botën.

Në një prej intervistave të saj, këngëtarja tha se do ta ndryshonte këngën tani nëse mundet.

"Ne kemi bërë një rrugë të gjatë. Bisexualiteti nuk ishte aq siç flitej atëherë, ose ndonjë lloj rrjedhshmërie.

Nëse do të më duhej ta shkruaja atë këngë përsëri, me siguri, do të bëja një modifikim të saj.

Lirisht, ajo ka disa stereotipe në të. Mendja juaj ndryshon aq shumë në 10 vjet dhe ju rriteni aq shumë".



MADONA "LIKE A VIRGIN DHE HOLIDAY"

Në një intervistë për një radio në Nju-Jork, Madonna tha:

"Nuk jam e sigurt që mund të këndoja këngët "Like A Virgin" dhe "Holiday" përsëri. Unë, thjesht, nuk mundem, përveç nëse dikush më ka paguar 30 milionë dollarë ose diçka e tillë".



CELINE DION "MY HEART WILL GO ON"

Celine Dion tha në prill të vitit 1997 në Las Vegas se u kontaktua nga kompozitori James Horner dhe i ofroi një projekt.

Ajo tha se kur Horner filloi të luante dhe të këndonte "My heart will go on", ajo u përpoq t'i tregonte burrit të saj që nuk i pëlqente kënga.

Ajo po i jepte të gjitha llojet e sinjaleve, duke e bërë të ditur se dëshironte të largohej, por ai bëri sikur nuk e vuri re.

"Boom"



EXPECT THE UNEXPECTED

SUMMER SEASON WILL OPEN FROM 4TH MAY



Edhe bliri i Mitrovicës e di sa jemi dashur!

Kur më the: “Nesër eja te vendi ku jemi takuar për herë të parë!”, atë ditë dita kaloi si me dhunë. Natën nuk më zuri gjumi, kurse kur erdh mëngjesi, me zemrën që më rrihte pa masë, u nisa dhe m’u bë sikur udhëtova një shekull rrugë derisa u gjeta përballë teje e syve tu...



KA KALUAR KOHË

PA U TAKUAR!

Eh, sa kohë ka kaluar pa u takuar!

Dhe, pas krejt asaj kohe, sot të mbaj dhe një herë në përqaftimin tim, teksa biseduam për shumëçka: për dëshirat tona që tash kanë mbetur veç ëndrra.

Po në këtë vend dikur jemi takuar dhe i kemi thënë njëri-tjetrit se vetëm vdekja mund të na ndajë!

Në këtë vend jemi takuar herën e parë dhe shumë herë të tjera...

Po në këtë vend ka qenë edhe takimi i fundit, i pranverës së vjetme...

PAS ÇDO TAKIMI THOSHIM: KJO ËSHTË HERA E FUNDIT!

Ja, edhe një herë u takuam në atë vend! Por, këtë herë më ndryshe se herëve të tjera...

Kërkova që të përqaftuar të ngrihem i përtej kufijve të mundësisë sonë, të shkojmë në amshim... Dashuria ime, a thua, a e kanë dëgjuar dhe ndjerë atë ditë ndarjen tonë Zoti, dielli dhe engjëjt?

Edhe ata do të kenë qarë, sepse ti u përcaktove t’i takosh dikujt tjetër...

Edhe ti e edhe unë e dimë se dashuria jonë ka qenë e pamundur të kurorëzohet me martesë dhe pas çdo takimi thoshim: Kjo është hera e fundit!

Por, ditën tjetër takoheshim sërish, sepse Zoti kishte dashur të takohemi edhe herë të tjera, që ta kuptojmë se sa shumë dashurojmë njëri-tjetrin, edhe pse që të dy e dinim se ai nuk ishte tjetër veç takimi i ndarjes.

Se as lotët tanë të singertë e as krejt ajo dashuri që ende e kemi për njëri-tjetrin, e as edhe këto dy zemrat tona të pafajshme, e as asgjë tjetër në jetë nuk mund ta ndryshonte fatin tonë...

ATY KU U TAKUAM EDHE U NDAMË!

Te bliri në Mitrovicë jemi takuar shumë herë. Dhe, vetëm ai vend e di sa shumë jemi dashur unë e ti!


E, po në atë vend edhe u ndamë përgjithmonë...

Samiu, Prishtinë

“Sheherzadja” dikur dhe tash



...dikur



...tash

A u kujtohet “Sheherzadja”? Ka ndryshuar komplet pamjen e saj...

Berguzar Korel, aktore turke, u bë e famshme me rolin e “Sheherazades” në serialin “1001 net”, ku rrëmbeu zemrat e publikut në mbarë botën, e veçmas te ne, shqiptarët.

Historia e saj e dashurisë nga ekrani i vogël u transferua në jetën reale, ndaj që 15 vjet jeton me kolegun e saj, Halit Ergents.

Por, pamja e Berguzar Korelit dikur ishte krejt ndryshe. Tash ka ndryshuar shumë dhe askush nuk besojmë se do e njihnte.

Aktoret i pëlqen të eksperimentojë me flokët dhe ngjyrën e flokëve, ndaj ishte edhe flokëkuqe, edhe me flokë të zeza.

Por, fotot e fundit në “Instagramin” e saj e mbështesin këtë, pasi bukuroshja Sheherazade tashmë i është bashkuar klubit të biondeve.

Përveç ndryshimit të ngjyrës së flokëve, ajo tani ka një model flokësh “burrëror” që i rri mirë me nuancën e re.

Dashnoret më lanë pa u martuar!

Këto ditë i mbushi 46 vjet dhe ende nuk kam pranë vetes ndonjë femër serioze për martesë. Kam pasur shumë lidhje të shkurtra me vajza, por jo edhe gjatë. Edhe sot jam në kërkim të një vajze të bukur, e që do të jetë nuse në shtëpinë time. Po pres, por vitet po kalojnë, ndërkaq moshatarët e mi kanë edhe fëmijë, madje të rritur...

Jam nga Peja. Në kohën e studimeve kam banuar në Prishtinë. Dhe, thënë të drejtën, nuk kam hequr shumë për femra, sepse i vardissha sa një femre sa një tjetre.

Femrat i njihja, kryesisht, në ligjërata, por edhe në oborr të fakultetit. E mira ishte se unë nuk kisha problem me para, sepse babai im, qëkur isha fëmijë, kishte një argjendari dhe puna i shkante mirë.

HEJ, NJERI, I ÇMENDE FEMRAT!

Ishte fakt se femrat shumë shpejt binin në dashuri me mua. Kur shiko-hesha para pasqyrës e lëmoja fytyrën, duke i thënë vetes: "Hej, njeri, i çmende femrat!".

Por, aso kohe nuk e dija të vërtetën: ato më kishin dashuruar veç se kisha para...

Dhe, kur i kujtoj ato çaste, habitem se kur pata kohë për të mësuar...

KALOI EDHE AJO KOHË!

Sot gjithçka po më shkon mbrapsht. Ndodhem para një udhëkryqi të madh: Si t'ia bëj me martesë?

Vetëm për një gjë mburrem: secila femër që e kam pasur ishte më e bukur se tjetra...

Më së shumti gëzohesha kur nda-hesha nga një femër e bëja turr pas një tjetre... Tashmë nuk dua t'i kujtoj më gjatë ato vjet, sepse dashnoret më lanë pa u martuar.

Prandaj, dua të bëj një ndryshim në jetën time: ta gjej një femër që të martohem, pa e pyetur fare sa frajera i ka pasur para meje...

Se, po ta pyes do të mbes me gishta n'gojë si deri tash...

Y. Xhevati

Si me e nxjerrë dreqin që e kam në bark?!

Në një fshat të Suharekës, kur shko-va për një shkrim, në mes të oborrit një trup fiku kishte fruta. Siç themi në gjuhën popullore, fiku ish bërë rrush...

Kur e kishte mbjell i zoti i shtëpisë, fqinji i kishte thënë: "Këtu nuk kemi det! Po e mbjellë kot!".

Ai ia kishte kthyer: "Ka për t'u bërë! Sepse, klima në Suharekë është e nxehtë si në Shqipëri".

Dhe, këtë meselë ma tregoi i zoti i shtëpisë së fikut, atë ditë gushti në shtëpinë e tij... I zoti i fikut, në një çast, më tha:

"E sheh fqinjin tim që shikon kah ne! Nuk ka më inatçi. Kur e mbolla fikun, ra në "prush" duke më kundërshtuar. Kinse si agronom, i ka dal zëri si ekspert, pa qenë fare...

E, fqinji i inatosur, kishte shkuar në Shqipëri me kamionetë dhe e kishte nxjerrë një fikë me gjithë dhe, dy herë më të madh se timin dhe e mbolli në oborr. I thashë: "E di se ke mbjell fik, por ideja për mbjelljen e fikut në Suharekë ishte imja!". Dhe, fjalë pas fjale e inat pas inati, gati u kacafytëm!", më thotë bashkëbiseduesi im.

INATET KOSOVË-SERBI

Kosova a Serbia kur shënojnë ndonjë fitore, apo kur duan ta kundërshtojnë njëra-tjetrën, i nxjerrin bajrakët dhe i varin nëpër ballkone!

Shqiptari nuk e ka dert pse kthehet këmbas, për ta nxjerrë nga barku dreqin që dikujt t'i shprehë diçka që ka harruar. Një burrë, kalimtar rasti, troket në një shtëpi, pasi e kishte zënë nata. I zoti i shtëpisë i bën konak.

Të nesërmen në mëngjes, zonja e shtëpisë kishte gatuar lakror. Dhe, pasi ngopet mirë, kërkon izen, siç thuhej në fshat. Por, në dalje të fshatit i bie në mend se lakrori nuk kishte pasur mjaft kripë. Andaj, nga inati, vendos të kthehet në familjen që i kishin bërë konak, në mënyrë që t'u tregojë se lakrori ishte pa kripë.

A DO TA QOJË KURTI DERI NË FUND MANDATIN?

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë kohës sa ishte në opozitë, nuk linte asnjë kryeministër aktual pa e kritikuar, derisa vetë u ul në postin e kryeministrit. E tash, kur është kryeministër, po bën histori, duke e qar deri në fund mandatin. Nuk ka rëndësi keq a mirë, sukses a dështim, me rëndësi është që në fushatën e ardhshme zgjedhore të thotë se është i vetmi kryeministër që e ka qar deri në fund mandatin.

S. M.

“Martesa” ime me një foto e kartolinë!

Isha në Shkollën Teknike në Ferizaj. Në pushimin e gjatë Ajo erdhi pranë meje, më shikoi gjatë në sy dhe ma shtrëngoi dorën fort...

Nuk ishte para dyzet vjetësh si sot kur të ofrohet një vajzë, sepse sytë e të gjithëve kthenin kah ti dhe gojët pëshpëritnin brenda klasës, si shushurimat e dushkut të tharë në mal.

Në çdo pushim të gjatë, ajo vinte nga klasa tjetër dhe gjente një arsye që vinte... E, ditë pas dite në shkollë u përhap lajmi se unë kisha bërë femër, e cila ndodhej në klasën tjetër, me të cilën më ndante vetëm muri.

NUK DIJA AS VETË ÇKA DOJA...

Nuk di nëse e doja, apo ishte më shumë ëndërr!

Nuk di nëse kishim diçka bashkë për të ardhmen, derisa akoma askujt nuk i kisha thënë të dua!

Por, as ajo nuk më kishte thënë se më donte!

Dhe, pas një kohe erdhi koha e praktikës mësimore, që vazhdonte pas përfundimit të orarit të rregullt mësimor, në objektin që njihje si “Reperti i praktikës”, ku i vishnim mantelet e kaltër.

E, teksa bëhesha gati të filloja punën, Ajo erdhi dhe më uroi ditën e parë të praktikës.

Më tha se manteli i kaltër më rrinte mirë me flokun paksa ngjyrë kafe...

E, kjo më dha të kuptoja se ajo më donte. Ndërkaq, unë s’kisha nevojë t’i thosha se e dua, sepse isha i bindur se ajo e dinte një gjë të tillë...

Dhe, teksa i sillja në mendje këto gjëra, ma lëshoi në dorë një foto. Më tha se do takoheshim pas praktikës...

Kur e kryem orarin e praktikës, jashtë binte shi i imët. Hapi ombrellën e kuqe dhe më



mori në mbrojtje nga shiu.

Mirëpo, teksa ecnim pranë njëri-tjetrit, më tha: “Jam e bindur se di të shkruash letër dashurie! Ma sill nesër një të tillë!”

Në shtëpi tërë natën u orvata t’ia shkruaja një letër. Por, posa e përfundoja e bëja truç dhe e hidhja në shporetin ku ndizeshin drutë, sepse nuk isha i kënaqur me mënyrën e shkrimit.

E, kur u takuam, më tha:

“Hë, ku është letra?!”

“Në zjarr!”, i thashë.

“Si në zjarr?!?”

“Në zjarr, sepse sado që jam munduar, nuk mund ta përfshija me fjalë atë që ndiej në shpirt për ty!”, mezi i thashë.

KUJTIMI PËR FOTON NË RAMIN PREJ XHAMI...

Ditë më vonë, foton e saj e dërgova te xhamprerësi dhe i thashë ta vente në ram xhami, të cilin që nga ajo ditë e mbaja fshehur në shtëpi, sepse do më qortonte baba po t’ma shihte.

Por, në vitin e dytë të shkollës së mesme, ndodhi e papritura.

Ajo iku me familje në Gjermani...

Dhe, me atë ditë, kur nuk e pashë më, thashë me vete: “U mbyllë gjithçka nga jeta rinore!”

Mirëpo, muaj më vonë ndodhi një e papritur. Në raftin e letrave që vinin në shkollën tonë për nxënës, ishte edhe një kartolinë në emrin tim.

Shpejt e mora, e lexova të vetmen fjali që shkruante në të: “Përshëndetje nga Hanoveri i Gjermanisë! Era”.

E lexova edhe herë të tjera dhe doja të fluturoja nga gëzimi...

Por, në çast më erdhi një nervozë, e cila ma shoi aty për aty atë gëzim.

Era nuk ma kishte dërguar adresën se ku banonte, që t’ia ktheja një të tillë...

SI PËRFUNDOI GJITHÇKA ME NJË FOTO E KARTOLINË?!

Dhe, teksa e ruaja atë kartolinë, si dhe foton në ramin prej xhami, pas sa vitesh, një nip imi, i cili e dinte historinë time me Erën, kishte dëgjuar se Era shkonte nuse në Amerikë...

E, ky ishte grushti që më qiti nokaut dhe më s’kisha arsye të zgjohesha nga ajo kllapi që më kishte kapluar...

Por, mbrëmë, 40 vjet më vonë, në kohën që e kisha harruar qëmoti, Erën e pash në ëndërr.

Ajo, me fëmijë në krah, vinte drejt meje.

E qeshura e saj ishte si e kohës së rinisë, por jo edhe fytyra e saj, sepse kishte rrudha mbi vetullat e trasha.

Dhe, kur zgjata dorën t’ia prekja flokët, brof më doli gjumi, kurse djersët ma kishin kapluar trupin.

“Hajr qoftë!”, thashë me zë të ultë, që të mos e zgjoja gruan nga gjumi...

Sokol Murturi



Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco
vaten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444

Pse disa burra kënaqen kur rrejnë?!

Ka pasur burra të mirë që kanë pleqëruar këmbëkryq në oda. Por, ka pasur edhe gra që kanë qenë më burrërore se burrat, krenare me dinjitetin e tyre...



Halla Bibë ka qenë grua burrërore. Ajo hynte në odë kur e qonte bukën te burrat dhe qëndronte aty sa ishte normale të qëndrojë në odë zonja e shtëpisë, kur odat kishin trapazan.

Babai im, me plisin bardh si bora në kokë, e mbushte sipërfaqen nën trapazan me dru.

Mbi qilimat e odës kishte postajë ogiçësh, të bardhë e të zinj, mbi të cilët uleshin mysafirët.

Kur mbushej oda burra, unë, si fëmijë, mezi gjeja një vend të dera që t'i dëgjoja muhabetet dhe historitë e tyre...

BABAI KISHTE SHOKË TË IDEALIT

Mbaj mend se një mbrëmje vjeshte të vonë, erdhën katër burra nga Vërmica e Prizrenit në odën tonë, me qeze të mbuluar.

Babai u gëzua shumë kur i pa. Mysafirët pasi u morën ngrykë me babën, u ulën në odë, si të ishin në odën e tyre.

Dhe, nga gëzimi për shokët e idealit, babai e qoi një fëmijë ta thërriste fqinjën tonë, Maliqin.

E, kur ai erdhi, i tha t'ia bënte kurban vëçin më të mirë.

Dhe, pas darkës së mirë, në odë filluan t'i shkepnin çajat.

Ndërkohë, vazhdonte muhabeti, herë me zë të ulët e herë me zë më të lart, varësisht nga biseda që bënin.

Më vonë e kam kuptuar se kur flisnin me zë të ulët, muhabeti bëhej për Shqipërinë.

Sepse, të flitej për Shqipërinë në atë kohë ishte e ndaluar, të mer-

rnin në pyetje, herë-herë edhe të shkallmonin dru...

PSE RAMA RRENTE SHUMË?

Por, të kalojmë te titulli i këtij shkri-mi. Në odë herë-herë bëheshin edhe biseda që neve, fëmijëve, na bënin të qeshnim.

E, një nga kujtimet që më ka mbetur në mendje është ajo e fqinjit tonë, Ramës, i cili ishte i dhënë shumë pas gjahut.

Në mbrëmjen që ishin mysafirë shokët e idealit të babës nga Vërmica e Prizrenit, ai nuk la pa u kyç në muhabet.

Tregoi se dy ditë më parë, tekta ishte për gjah në malin që e kishim afër, në Presedel, dëgjon një shushurimë.

Fshihet pas një lisi të gjatë dhe pret gjahun që i afrohej.

Dhe, kur shushurima vinte gjithnjë duke u rritur, Rama vëren se ishte një derr i egër.

E vë në shënjestër të manzerës dhe pas shkrepjes së tre plumbave sheh se derri i egër veç u shtri në tokë.

"Kur iu afrova ia dhashë edhe një plumb në kokë, sepse frikohesha mos do ngrihej e do më sulmoj..."

Dhe, kur pashë se më ai nuk lëvizte, iu afrova afër, u mundova ta tërhiqja për bishti kodrës teposhtë, por ishte i rëndë, mbi 300 kilogramë. Shkova në shtëpi, e mora një kosë dhe e copëtova...", tha Rama, tekta të tjerët me të madhe nisën të qeshin se me çka e mati që derri i egër peshonte 300 kilogramë.

S. Krivaça

E dashura e burrit tim kërkoi të pinim kafe bashkë!

Nuk ma merrte mendja kurrë se mund t'më ndodhte edhe mua ajo që shumë të tjera e kanë kaluar përpara meje, por përjetimi i tradhtisë qenka shumë i tmerrshëm, sidomos kur je në njëfarë moshe siç jam unë.

Jam 55 vjeçe. Jam njohur dhe jam martuar me tim burrë me dashuri. Ai ka qenë burrë i mirë, edhe pse më e dhënë pas familjes kam qenë gjithmonë unë. Pasi kemi kaluar thuajse 30 vjet bashkë, kuptova se im burrë, e që e kam vlerësuar gjithmonë, më tradhtonte përpara syve të mi.

SI NISI TRADHTIA E TIM BURRI?

I kemi dy banesa në të njëjtën ndërtesë, njëren prej të cilave e kemi dhënë me qira qëmoti. Në të banojnë dy vajza që sapo kanë kryer fakultetin dhe kanë gjetur punë. Por, nuk ka shumë kohë që njëra nga to më kërkoi të pinim kafe afër punës sime.

Mendova se mund të kishte ndonjë hall dhe se kishte nevojë për ndihmë, megjithëse m'u duk e çuditshme që më kërkoi të mos e pinim kafën në banesën time, siç bënim zakonisht.

Nuk e vrava shumë mendjen dhe dola ta takoja. Ajo dukej e shqetësuar. Fillova ta merrja me të mirë, ta qetësoja, duke i thënë se nuk ka gjë që nuk kalohet në jetë. Dhe, sa budallaqe m'u duk vetja më pas, kur kujtova këto fjalë që i kisha thënë! U ulëm dhe ajo hezitonte të fliste. Fillimisht më kërkoi falje dhe u justifikua për atë çka kishte bërë. Deri këtu nuk kisha marrë vesh asgjë se çfarë kishte ndodhur, por mendja më shkoi se do të kishte ndodhur ndonjë gjë në banesë, ndoshta kishin prishur ndonjë mobilie apo ndonjë gjë tjetër dhe më dukej shumë absurde që ajo qante.

I thashë që të mos shqetësohej se nuk kishte gjë të pandreqshme, por kurrë, për asnjë çast, nuk më shkoi mendja te ajo që do t'më tregonte...

Ajo filloi të fliste më shkoqur, me zërin që i dridhej. Më tha se ishte në lidhje me burrin tim...

Në atë moment shtanga, nuk u besoja veshëve për atë çka dëgjova dhe nuk arrija dot as të flisja.

Ata kishin më shumë se dy vjet që ishin bashkë. Im shoq, për nga mosha, mund të ishte babai i saj, por kjo nuk e kishte penguar vajzën...

Nuk kishte menduar as për faktin se, kështu, po e shkatërronte një familje...

Sipas saj, njeriu nuk mund ta komandoje dot zemrën dhe dashuria nuk njihet moshë. Kështu e justifikonte ajo lidhjen me burrin tim.

Dhe, pasi m'i tha të gjitha këto, më doli nga shpirti një pyetje ku doja të gjeja shpëtim: "Po bën shaka, apo jo?"

Sipas saj, burri im donte të ndahej prej meje, por nuk kishte guxim t'ma thoshte. Tutje më tha se im shoq donte të niste një jetë të re me të dhe unë nuk duhej ta pengoja.

I thashë se do flasë me bashkëshortin tim dhe se kur t'i vërtetoja fjalët e saj, do të isha unë ajo që do të ndahesha prej tij, sepse nuk mund të jetoja me një njeri që më kishte tradhtuar paturpësisht, madje në banesën time!

SI E MOHOI IM BURRË TRADHTINË?!

Kur shkova në shtëpi e pyeta menjëherë tim shoq për ato që më kishte thënë vajza. Ai i mohoi të gjitha dhe tha se ajo po i sajonte, po se për çfarë arsyeje ajo duhej të shpikte gjithë këtë histori, ai nuk e kishte idenë...

Dhe, edhe pse e thyer në shpirt, vendosa ta falja tim burrë, me të vetmen arsye që ta ruaja bashkëshortësinë.

Por, së pari i largova nga banesa qiraxhiket, sepse nuk kishte më kuptim të rrinin në banesën time pas gjithë asaj që kishte ndodhur.

Dallëndyshja, Ferizaj

Fqinji im ua shnukë myshterinjve nga 50 centë!

Shkoj në shitoren e fshatit tim dhe e blej një birrë gjermane "Beks". Shitësi nuk i ka 50 centë për t'mi kthyer. "S'ka gjë! Mos u mërzit, se askënd s'ë kanë bërë shtëpi 50 centë", ia kthej unë.

Ai, pasi më dëgjon me vëmendje, i vjen mirë që muhabeti për 50 centë u mbyll me kaq.

E, sa 50 centë në ditë i shnukë nga myshterinjtë?!, më shkon në mendje. Dhe, teksa dal nga shitorja, në derë të marketit takoj një shok timin të fëmijërisë, Nezirin.

Më thotë se mbrëmë ka ardhur nga Zvicra dhe, pa mëdyshje, nuk më lëshon pa ma qitur një makiato në kafenenë afër Shpellës së Mermertë. Brenda njerëzit pinë kafe e bëjnë muhabet. Një djalë rreth të 20-ave flet në telefon më zë të lartë.

I afrohet Neziri dhe ia jep një flak-areh!

"O Nezë, a je çmendur?! Më ftove për kafe e i dhe djalit të huaj flakareh!".

"Nuk është i huaj. Është djali im. S'ka nevojë të flas në telefon me zë të lartë! Në mëngjes ia transferova nga telefoni im 10 euro dhe deri në mbrëmje i

harxhon krejt!", më thotë.

"Mirë e ke Nezë. Çka nuk i fiton vetë nuk ia di kimetin!", i them, sa për ta përmbyllur këtë mesele.

MOS IA JEPNI PATENTËN GRUAS SIME!

Puna e patentë-shoferëve është bërë si boza e haxhi Turimit, thonë në vendlindjen time.

Nga më lindi ky mendim?

Na solli nga një pije kolegja e punës, në shenjë të qerasjes për patentë-shofer.

Dhe, mu kujtua gruaja ime...

Kur doli në test për të dhënë provimin për shofer, dola ta shihja se a do e vozitëte veturën mirë.

Kur u nis mu duk se u nisë shpejt, si me u nis me shpejtësinë e tretë!

Dhe, për nja 15 minuta më nuk e pashë...

Kur u kthye, shoferja e autoshkollës ia zgjati dorën dhe ia uroi.

U afrova dhe i thashë:

"Të lutem, rrëzoje! A e vërejte se si u nis shpejt, si të ishte në pistë aeroportit?! Rrëzoje se e thyen kokën ndokund dhe mbes pa grua!".

VETËM POETËT E DEHUR RESPEKTOHEN!

Në vitet 70 e 80 janë shitur shumë librat me poezi. Poezitë me përmbajtje patriotike ua kalonin edhe këngëve më patriotike të kohës.

U kemi duartrokatur edhe poetëve palaço kur kanë lexuar poezi patriotike...

Pas orëve të shpeshta letrare, që organizoheshin nëpër komuna, pasdarke shtrohej darka e rakia. E, në ato ndoja ishte krijuar bindja se poet i mirë është ai që ishte gjithmonë i pirë!

Por, edhe në ditët e sodit shpesh më rasisë të dëgjoj për një mentalitet të tillë.

E, një i tillë, ditë më parë, teksa pija kafe me kolegë, në një tavolinë afër nesh u fliste dy vajzave të reja dhe lavdërohej para tyre se si ka arritur të bëhej poet i madh...

Ato, pasi e dëgjuan teksa fliste poeti, i tha njëra-tjetrës: "Unë s'paskam me u bë kurrë poete!".

Por, unë, meqë nuk munda të durohesha, nga tavolina ime u them:

"Vajza, për t'u bërë poet është lehtë, e jo si poeti që jeni me të e po ua bënë kiamet! Sepse, kështu më kanë thënë edhe mua në fillet e mia poetike!".

S. M.

BLEJ
BANESË
NË FERIZAJ



+383 44 124 025

LAGJJA
PANORAMA

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A do të ndahemi?

Zonja magjistare, u përhëndes nga zemra!

Jam M., 38-vjeçare, jetoj në Belgjikë. Kam probleme me burrë që disa vjet.

Jam lodhur me të gjitha që kam përjetuar...

A do të ndahemi apo do të jetojmë bashkë?

"E lodhura"

Përgjigje:

Besoj se do ta vazhdoni jetën së bashku.

Femra që e ka gjetur burri yt, për fat të mirë, nuk është e familjes së keqe, por ky nuk ia ka treguar të vërtetën nga jeta e vet familjare, e ajo ka rënë viktimë e mashtrimit.

Prandaj, çdo detaj ka dal në dritë... Ajo do të tërhiqet posa t'i kuptojë disa gjëra që nuk i ka ditur.

E, ti mos u tensiono nga kjo situatë! Sepse, pas uraganit përsëri do të ngrohë dielli.

Pse flitet shumë për fatin?

Përhëndetje e nderuara magjistare, jam zonjë, 53

vjeçe, jetoj në Prishtinë.

Punoj në arsim. Në kolektivin tim ka shumë arsimtare të reja dhe flasin shumë për fatin e gjërat që lidhen me të...

Më intereson: Pse flitet shumë për fatin?

"Arsimtarja"

Përgjigje:

Gjërat hyjnore janë të padukshme! Shpirti e fati nuk duken, por besohen!

Fati është rastësi, apo, të paktën, bie në këtë grup.

E, rastësitë në psikologji, përfshirë edhe ëndrrat, sipas Sigmund Frojdit nuk janë edhe bash rastësi!

Njerëzit e kërkojnë fatin gjatë gjithë jetës dhe këtu nuk bëjnë përjashtim as presidentët botërorë, as liderët shpirtërorë, as besimtarët, as patriotët, e as zyrtarët me uniforma!

Pas fatit shkojnë të gjithë njerëzit e botës. Madje, edhe invalidët që nuk mund të ecin shpresojnë në fat!

Fatin e ndjekin edhe klubet

e sportive dhe reprezentacionet. Brazilianët luajnë me fanella të verdha tradicionale, sepse me atë ngjyrë kanë më shumë fat!

Andaj, secili reprezentacion e klub e ka një ngjyrë, nën të cilën i prinë më shumë fat!

Ka njerëz, madje edhe politikanë e zyrtarë, të cilët bartin në duar rrathë, penj apo gjësende të cilat sjellin fat.

Një nga politikanët që shihet me penj në dorë është edhe kryeministri Edi Rama.

Sidoqoftë, fati është i fshehtë dhe duhet kërkuar...

Andaj, nuk thonë kot: Paç fat!

Magjitë e Shëngjergjit

Jam nënë, 49-vjeçare. I përkas kohës që jemi mësuar me adetet tradicionale kur festonim Shëngjergjin.

Por, ia kishim frikën magjive të Shëngjergjit...

Shkurt, a është e vërtetë magjia e Shëngjergjit?

"Nostalgjia për Shëngjergjin"

Përgjigje:

Magjitë ekzistojnë dhe këtu nuk ka dilema. Hazreti Musa ka pasur aftësi të bëjë magji, madje në shumë mënyra.

Por, të ndalemi te pyetja jote për magjitë e Shëngjergjit, pse janë të fuqishme dhe ku e marrin fuqinë?

Magjitë e Shëngjergjit vijnë bashkë me beharin. Behari është gjelbërimi kur dielli ngrohë tokën.

Në këtë periudhë, në fillim-pranverë, në traditën popullore ka mbetur adet që i huaji të mos i shikojë fëmijët e shëndetshëm, sepse u bie mësysh! Sepse, syri shkakton probleme!

Nuset, gjithashtu, i ruanin shumë nga magjitë.

Sepse, nëse një nuse të bukur e shikonte një i huaj me kureshtje të madhe, ajo mund të pësonte çrregullime mendore dhe kjo gjë vjen nga një lloj vetëkrenarie që mund të krijohet te nusja.

Sepse, duke i hyrë vetja në qejf se duket e bukur, ajo mund të luhatet psikikisht!

Sidoqoftë, plakati kanë pasur aftësi të bëjnë magji. Shtrohet pyetja: Si bëheshin magjitë?

Në kohën pagane, secila grua që ka dashur t'i bëjë magji dikujt, është dashur të del lakuriq pas mesnate dhe ta bëjë magjinë, duke bërë bashkë thonj të pulës dhe flokë njeriu, e që i ka vendosur në shtëpinë ku ka dashur ta bëjë magjinë...

Thonjtë e pulës kanë pasur për qëllim grindjen në atë shtëpi, madje edhe rrahjen e njerëzve ndërmjet veti...

Ku ta kërkoj fatin pas ndarjes?

Jam 28-vjeçare, e ndarë nga burri, jetoj në Hanover të Gjermanisë.

Unë, realisht, e kam dashur dikë para martesë.

E, edhe ai ma ka dashur shumë...

Mirëpo, një ditë u zbulua lidhja që kam pasur para martesë dhe, kështu, martesë ime nisi të shkatërrohej, sa që me burrë edhe u ndamë.

Ku e kam fatin e ri?

“Dashuria për tjetrin!”

Përgjigje:

Ajo që del te unë është se ish-burri yt ende është i mllefosur në ty.

Sepse, ai po ndihet i tradhtuar nga ti që nuk i ke treguar në hollësi për jetën tënde para martesë...

Por, gjatë kësaj vere më del se do i kaloni pushimet bashkë dhe dashuria juaj do të stabilizohet...

A ekzistojnë fantazmat?

Jam një femër në moshë, që jeton në Zvicër.

Para ca ditësh lexova se si një zonje i kanë dal para veturës fantazmat me dritë në duar dhe i kishte fotografuar me celular.

Jam kureshtarë të di: A ka fantazma?

“Plaka nga Zvicra”

Përgjigje:

Nga e kaluara mistike dhe praktike e të jetuarit, ka shumë fakte se nata i ka qeniet e veta, të cilat bredhin natën.

Pse natën?

Sepse vetëm natën ato shëtisin sh lirë...

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Në botën e mistikës thuhet se aty ku kanë rënë njerëzit dhe gjaku, shpirti ka mbetur aty! Dhe, mu në ato vende edhe paraqiten fantazmat. E, se fantazmat ekzistojnë, kemi pasur rastin të shohim edhe dokumentarë të ndryshëm, kryesisht në kështjellat që nuk banon askush, që janë boshe.

Thuhet në qarqe zyrtare se pamja e ish-presidentit legjendar amerikan, Ruzvelt, shfaqet nëpër Shtëpinë e Bardhë, para çdo krize që mund ta ketë Amerika.

A do të përmirësohet lidhja ime me burrin?

Jam nënë e dy fëmijëve. Deri më tani kam qenë e lumtur me burrë, por ka një kohë që kam një brengë të madhe, sepse po grindemi shumë, madje edhe pa nevojë! A është kjo fazë e jetës martesore apo është diçka më shumë?

“Arianita”

Përgjigje:

Jeta bashkëshortore është një treg i përditshëm, në të cilin blihet lumturia, e ardhmja. Andaj, është me rëndësi të keni besim në njëri-tjetrin dhe jo të krijoni mëdyshje...



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE